# DËSHMI ARKIVI

**A-442130**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dita e parë e shkollës paralizon trafikun në kryeqytet, punëtorët rrezikojnë ditën e punës |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1391452.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 07:03:55 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 14 shtator 2026, 06:54:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 14 shtator 2026, 06:53:00 UTC → 14 shtator 2026, 06:55:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2e273fbb4ecf3084e101e3c2ed796861af3acfa2deb9cea1dfa9c8f7773cd5b1` |
| TEKSTI | `e2f6cf32cbc28cdc767da49c221777191c2f5d39cae1a62823d886b50022d898` |
| PAMJA | `251840d36af06b1b81f05ccfd2a68492d367f276a612423f87fb4b1a467e6661` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `46f90500cc35b9953e347ed7eb02335693f5182064330e6a87185fbb0b64ca44` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/46f90500cc35b9953e347ed7eb02335693f5182064330e6a87185fbb0b64ca44`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Dita e parë e shkollës paralizon trafikun në kryeqytet, punëtorët rrezikojnë ditën e punës

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 14.09.2026, 08:54

Share Share




Dita e parë e vitit të ri shkollor ka nisur me trafik të rënduar në disa prej akseve kryesore të kryeqytetit.

Fluksi i lartë i automjeteve është shkaktuar edhe nga prindërit, të cilët kanë zgjedhur t'i shoqërojnë fëmijët e tyre me makinë në ditën e parë të shkollës. Kjo ka sjellë vështirësi të mëdha në qarkullim dhe bllokim të disa prej rrugëve kryesore të Tiranës.

Situata paraqitet e rënduar që në hyrje të kryeqytetit. Në zonën e Kthesës së Kamzës, qarkullimi është paralizuar, ndërsa trafik i rënduar raportohet edhe në Unazën e Madhe dhe përgjatë aksit që shtrihet deri në Paskuqan.

Por në rrugët e kryeqytetit, krahas nxënësve dhe prindërve, janë edhe mijëra punonjës që duhet të shkojnë në vendet e tyre të punës, si çdo ditë tjetër.

Të bllokuar prej trafikut, disa prej tyre thonë se rrezikojnë të humbasin ditën e punës, ndërsa pasiguria mbetet e madhe për kohën se kur do të mund të mbërrijnë në destinacion.

Kështu, dita e parë e shkollës ka sjellë jo vetëm emocionet e nisjes së një viti të ri për nxënësit, por edhe kaos në qarkullimin rrugor në disa prej hyrjeve dhe akseve kryesore të Tiranës.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.